



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 119, datë 06.06.2019

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI ADMINISTRIMIN E FONDIT TË
KOMPENSIMIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 46, pika 2, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e Transportit”, me propozim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullore së propozuar nga BSHS “Mbi administrimin e Fondit të Kompensimit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kjo rregullore miratohet për një afat 1-vjeçar.
3. Rregullorja nr. 36, datë 21.03.2012 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”, shfuqizohet.
4. Ngarkohet Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe Departamentet përkatëse të Autoritetit për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI